

# Udhëzues për marrjen e pëlqimit nga pacienti për trajtim stomatologjik

## Procesi i marrjes së pëlqimit

Përkufizimi i "pëlqimit" nënkupton kur një person-personit tjetër qëllimshëm ia jep aprovimin për të bërë diçka.

Pëlqimi mund të konsiderohet si *i nënkuptuar* për të vazhduar me ndonjë ekzaminim dhe/ose procedurë, me qenë se pacienti: është ulur në karrigë stomatologjike, u është përgjigjur pyetjeve të ndryshme dhe që nuk kundërshton.

Përtej pëlqimit të nënkuptuar, në praktikën stomatologjike janë edhe dy llojet tjera të pëlqimeve: *pëlqimi i përgjithshëm dhe pëlqimi i informuar*. Që të dyjat këto kërkojnë që stomatologu dhe pacienti të bashkëbisedojnë rreth tyre, si tema të vetme të diskutimit. Marrja e pëlqimit të përgjithshëm dhe pëlqimit të informuar duhet të përfshijë dy bashkëbiseda që dallojnë njëra prej tjetrës.

*Pëlqimi i përgjithshëm* bashkëbisedohet vetëm lidhur me kryerjen e procedurave të caktuara të cilat rekomandohen nga ana stomatologut. Marrja e pëlqimit të përgjithshëm d.m.th. se pacienti e jep lejen për të vazhduar trajtimin. Gjithashtu, ky pëlqim i lejon stomatologut kryerjen e procedurave minore stomatologjike si dhe faturimin preliminar të shërbimeve.

*Pëlqimi i informuar specifik* kërkohet për të gjitha procedurat tjera stomatologjike përfshirë edhe ato të papriturat. Pëlqimi i informuar nuk është vetëm një dokument që jepet për aprovim, por ai është një proces i tërë ku bashkëbisedohet dhe spjegohet në hollësi plani i trajtimit i rekomanduar nga ana e stomatologut, bazuar në statusin individual të shëndetit oral të pacientit. Pëlqimi i informuar kërkohet për çdo procedurë të bërë, përveç procedurave të mbuluara me pëlqimin e përgjithshëm dhe stomatologu është ai i cili duhet të bashkëbisedojë për këto me pacientin. Gjatë diskutimit, duhet të spjegohet shkalla e rrezikut gjatë procedurës në fjalë, dhe sa më i madh të jetë rreziku, aq më i hollësishëm duhet të bëhet bashkëbisedimi.

Thënë thjeshtë, pëlqimi i informuar është biseda gjatë së cilës stomatologu i jep pacientit informacione lidhur me:

- Problemet e observuara të shëndetit oral dhe të përgjithshëm,
- Natyrën e çfarëdo trajtimi të propozuar,
- Dobitë dhe rreziqet potenciale që e shoqërojnë atë trajtim,
- Çfarëdo alternativash ndaj trajtimit të propozuar,
- Dobitë dhe rreziqet potenciale të trajtimeve alternative, duke përfshirë këtu edhe mostrajtimin e gjendjes.

Pacientit duhet t'i jepet mundësia për të pyetur lidhur me opsionet e ndryshme të trajtimit që i janë prezantuar. Çdo procedurë, duke përfshirë edhe ato të komplikuarat, duhet të diskutohen.

Pëlqimi i informuar nuk mund të konsiderohet i vlefshëm në mungesë të bashkëbisedimit stomatolog-pacient.

Pëlqimi i informuar është edhe një mundësi për krijimin e raportit të mirë me pacientin, e me këtë, edhe trajtimin cilësor stomatologjik. Gjithashtu, bashkëbisedimi për pëlqimin e informuar mundëson përmbushjen e parimit etik të "autonomisë së pacientit" në kuptimin që biseda e involvon pacientin në vendimet për trajtim të tij/saj. (shih: vegëza e kodit etik të OSK për udhëzime).

Stomatologu duhet të marr pëlqimin e informuar nga pacienti/kujdestari para se të ofroj trajtimin stomatologjik.

Në pëlqimin e informuar duhet të përfshihet procedura e propozuar gjatë bashkëbisedimit e në veçanti procedurat komplekse të trajtimit. I njejt plotësohet pas bashkëbisedimit me pacientin dhe para fillimit të procedurës së diskutuar.

**Gjithmonë, konfirmoni që pacienti ta ketë nënshkruar formularin para ofrimit të trajtimit.**

Është praktikë e mirë që kartela e pacientit të përmbajë, së paku, ndonjë shënim që tregon se pacienti ka miratuar pëlqimin e informuar për të vazhduar me trajtimin e rekomanduar ose të dokumentohet që ai pëlqim nuk është miratuar dhe se ai trajtim nuk është bërë. Kjo e fundit njihet si "refuzim i informuar". (me preferencë në këto shënime të nënshkruhet me inicialet, vet pacienti)

Në rast se pacienti është nën moshë madhore dhe/ose jo kompetent për një gjë të tillë, pëlqimin duhet ta jep dhe/ose nënshkruajë prindi ose kujdestari.

Për çdo situatë të jashtëzakonshme që nuk referohet në këtë dokument, duhet konsultuar legjislacionin dhe ekspertizën përkatëse.

*SQARIM:: Udhëzimi i dhënë nga ky material përkitazi me marrjen e pëlqimit të pacientit për trajtim nuk kanë efekt detyrues, por kanë për qëllim sqarimin e praktikave të mira stomatologjike si mundësi për eliminimin e kontesteve në të ardhmen ndërmjet stomatologut dhe pacientit.*

*Marrja e pëlqimit për trajtim stomatologjik nuk liron profesionistin shëndetësor nga përgjegjësia ligjore dhe ajo etiko – profesionale për mjetet dhe metodat e ofruara gjatë tretmanit stomatologjik.*

---

**Ky udhëzues është marrur dhe përshtatur nga American Dental Association (ADA), duke e harmonizuar me dispozitat e Ligjit për Shëndetësi të Kosovës Nr.04/L-125 dhe Ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor Nr.2004/38.**

